

## VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Andi Çeliku	Kryesues
Evelina Qirjako	Anëtare
Artan Broci	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Tom Ndreca	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 25.04.2017, mori në shqyrtim çështjen që u përket palëve:

PADITËS: SHKËLQIM BERISHA

PALË E PADITUR: MINISTRIA E MBROJTJES  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS  
PUBLIKE

### OBJEKTI:

Shfuqizimin e vendimit nr.10476 prot., datë 01.11.2013 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes; Shfuqizimin e vendimit nr.1552/1 prot., datë 01.11.2013 të Departamentit të Administratës Publike që miraton vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes; Kthimin në vendin e punës, pra në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burimeve të Modernizimit ose në një vend të barazvlefshëm me të në Shërbimin Civil. Dhënien e pagës së Drejtorit të Përgjithshëm të Burimeve të Modernizimit ose të një pozicioni të barazvlefshëm me të, nga data 01.11.2013 deri në kthimin në vendin e punës.

Baza Ligjore: Nenet 20, 44, 47, 51, 56, 93, 94, 95, 108, 109, 115 e në vijim të K.Pr.Administrative, nenet 3/3, 7/a, 11/1, 15/a, 16, 17, 18 të Ligjit nr.49/2012, Ligjit nr.8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil"; VKM nr.306/2000 "Për disiplinën në shërbimin civil" dhe VKM nr.360/2000 "Për lirimimin nga shërbimi civil"; Ligji nr.152/2012 "Për nëpunësin civil".

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1657, datë 15.04.2014, ka vendosur:**

- Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetur në ligj dhe prova.
- Shpenzimet gjyqësore të provuara si parapaguara janë në ngarkim të palës paditëse".

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2165, datë 14.10.2015, ka vendosur:**

- Ndryshimin e vendimit nr.1657, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Pranimin e kërkesëpadisë;
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.10476 prot., datë 01.11.2013 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të vendimit nr.1552/1 prot., datë 01.11.2013 të

Departamentit të Administratës Publike;

- Detyrimin e palës së paditur të rikthejë paditësin Shkëlqim Berisha në detyrën e mëparshme ose në një detyrë ekuivalente me të;
- Detyrimin e të paditurit Ministria e Mbrojtjes t'i paguajë paditësit pagën, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në ekzekutimin e këtij vendimi;
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur;
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv, të ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor;

**Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs pala e paditur Ministria e Mbrojtjes, e cila kërkon ndryshimin e vendimit nr.2165, datë 14.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63/e të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

#### V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr.2165, datë 14.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 25.04.2017

**Nr. 31003-00133-00-2016 i Regj. Themeltar  
Nr. 00 - 2017 - 544 i Vendimit ( 332 )**